

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga 01.01.2013 deri 30.06.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 195 datë 31.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 890/8 datë 31.12.2014, dërguar Z. Spëtim Spahiu, Drejtor i Përgjithshëm i DSHTD, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

1. MASA ORGANIZATIVE

1. DSHTD ka sponsorizuar Federatën Shqiptare të Peshëngritjes, në një vlerë më të madhe prej 582,000 lekë, se përcaktimi në VKM nr. 244, datë 27.05.1993, “Për sponsorizimin nga ndërmarrjet shtetërore të subjekteve të ndryshme”, pasi ka përdorur më shumë se sa 0.5% të fitimit vjetor të realizuar pas zbritjes së tatimit për vitin 2012.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Drejtues i DSHTD-së, në të ardhmen mos të tejkalojë kufijtë ligjorë përkatës gjatë procedurave të sponsorizimeve, sipas VKM nr. 244 “Për sponsorizimin nga Ndërmarrjet Shtetërore të subjekteve të ndryshme”

Vazhdimisht

2. Këshilli Drejtues, në dy objekte të dhëna me qira, ka vendosur tarifa fikse, përkatësisht për sipërfaqen e objektit 259 m² me tarifë 400 lekë m² dhe për 254.5 m² truall i lirë funksional me tarifë 200 lekë m², për një afat të dhënies me qira prej 20 vjet, pa marrë parasysh indeksimin e çmimeve për një periudhë afatgjatë.

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Drejtues, të revokojë dhe të rishikojë tarifat e qirasë për dy objektet e kontraktuara, duke përfshirë me paragraf të veçantë indeksimin e përvitshëm të tarifave për periudha afatgjatë, për të vepruar në interes të entit publik.

Vazhdimisht

3. Këshilli Drejtues, gjatë procedurave të punësimit ka vendosur kritere të përgjithshme për pozicione të veçanta pune, pa përfshirë specifikime në lidhje me ndarjen e specialistëve në kategori, llojin dhe nivelin e arsimit etj., duke ndikuar në performancën e punonjësve të rinj.

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Drejtues, të hartojë, miratojë dhe të zbatojë kritere të përgjithshme dhe të veçanta sipas pozicioneve përkatëse për marrjen në punë, duke përfshirë dhe përvojën në punë, llojin dhe nivelin e arsimit, kategorinë e specialistëve etj., në funksion të rritjes së performancës së të punësuarve rishtas.

Vazhdimisht

4. Këshilli Drejtues, ka miratuar propozimin e Komisionit Teknik të Vlerësimit dhe ka vendosur nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të DSHTD-së për vitin 2012, në vlerën totale 1,739.8

mijë lekë, pa kryer analizën mallrave që janë nxjerrë jashtë përdorimit së bashku me dokumentacionin përkatës për çdo artikull që nuk ka plotësuar normën e amortizimit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 111 deri në 120.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Drejtues të hartojnë gjurmë të plotë auditimi për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe Komisionit Teknik i Vlerësimit të hartojë analiza të detajuara të mallrave që do të nxirren jashtë përdorimit së bashku me dokumentacionin përkatës, përfshirë normën e amortizimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Vazhdimisht

5. Këshilli Drejtues ka rritur shpenzimet operative të entit në mënyrë të pajustificuar dhe të paargumentuar, duke vendosur kontraktimin e një Studio Ligjore për të përfaqësuar DSHTD-në në çështje gjyqësore, megjithëse në strukturën organike ka Sektorin Juridik të përbërë nga 5 jurist dhe një këshilltar juridik.

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Drejtues, para miratimit të shpenzimeve me të tretë për çështje juridike, të kryejë një analizë të hollësishme të raportit kosto-përfitim, duke angazhuar fillimisht kapacitet brenda entit, për të përfaqësuar DSHTD-në në çështje gjyqësore dhe të tjera, pasi ka sektorin dhe stafin e nevojshëm për këtë qëllim.

Vazhdimisht

6. Këshilli Drejtues ka miratuar kërkesën për shpenzime në angazhimin e një studioje private, pa ju referuar përfitimeve të mundshme të entit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e DSHTD-së”, si dhe me Kreun II të Statutit të DSHTD-së, miratuar nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Drejtues, gjatë shqyrtimit dhe miratimit të vendimeve të ndryshme, të kërkojë në çdo rast relacione përkatëse nga DSHTD-së, me qëllim që të veprohet në interes të entit publik.

Vazhdimisht

7. Këshilli Drejtues ka vendosur që për dhënien e ambienteve me qira t’i drejtohet dhe agjencive imobilare, duke rritur koston dhe ulur përfitimet e DSHTD-së për kontrata qiraje me afat 1 vjeçar me të ardhurat e një muaji, ndërsa për afate më të vogla se një vit, në përpjesëtim me muajt e kohëzgjatjes së kontratës së qirasë. Për më tepër në strukturën e DSHTD-së ka specialiste marketingu, si dhe nuk janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë e reklamimit të ambienteve në site online papagesë dhe mënyra të tjera marketimi.

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Drejtues të revokojë vendimin për dhënien me qira të ambienteve nëpërmjet agjencive imobilare, duke shfrytëzuar paraprakisht të gjitha mundësitë e reklamimit të ambienteve nga specialisti i marketingut, në site online papagesë dhe në mënyra të tjera marketimi.

Menjëherë

8. Strukturat drejtuese e vartëse të ndërmarrjes nuk kanë përgatitur një udhëzim për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programeve ekonomike financiare, ku të përcaktohen procedurat, përgjegjësitë dhe afatet e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programit të zhvillimit të DSHTD-së.

Për sa më sipër rekomandojmë

DSHTD të përgatisë dhe të paraqesë në Këshilli Drejtues një udhëzim për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programeve ekonomike financiare, ku të përcaktohen procedurat, përgjegjësitë dhe afatet e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programit të zhvillimit, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Brenda muajit janar 2015

9. DSHTD-së ka tejkaluar shpenzimet për paga e shpërblime dhe në shërbime e dieta gjatë vitit 2013 në masën 30 % më shumë se plani, duke evidentuar mangësitë e programimit të shpenzimeve dhe ndjekjes së tyre gjatë veprimtarisë së entit.

Për sa më sipër rekomandojmë

DSHTD, të marrë masa për një programim sa më të saktë të shpenzimeve, për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë periodikisht në realizimin e treguesve ekonomik dhe financiar të entit, si dhe duke shmangur ndryshimet e tyre gjatë vitit.

Vazhdimisht

10. Nga auditimi i pasqyrave financiare të ndërmarrjes të mbyllura në 31.12.2013 nuk ka të paraqitur asnjë vlerë në zërin “Truall”, megjithëse në dokumentet e hipotekës ka të regjistruar sipërfaqet e truallit mbi të cilën ushtron aktivitetet ndërmarrja. Po kështu zëri “Ndërtesa” paraqitet në Pasqyrat Financiare me vlerën e tyre në momentin e ndërtimit, vlerë e cila për pjesën më të madhe të tyre janë me çmimet e para viteve '90.

Për sa më sipër rekomandojmë

DSHTD të marrë masa për regjistrimin e truallit dhe ndërtesave në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, sipas kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, si dhe vlerësimin e truallit dhe aktiveve afatgjata materiale, duke i përfshirë në evidencën kontabile të DSHTD-së.

Brenda tremujorit të parë 2015

11. Në mbyllje të vitit 2013, DSHTD ka paraqitur në pozicionin e kërkesave për arkëtim shumën 3,294,548 lekë, të cilët janë klient më të vjetër se 365 ditë, pa njohur zhvlerësimin e këtyre të drejtave për arkëtim dhe që rezultojnë në rritje të shpenzimeve të zhvlerësimit me këtë shumë.

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Drejtues të rivlerësojë pozicionin e kërkesave për arkëtim shumën 3,294,548 lekë, të cilët janë klient më të vjetër se 365 ditë, pasi kjo e drejtë duhet të zhvlerësohet në përputhje me legjislacionin përkatës dhe do të sjellë rritje të shpenzimeve të zhvlerësimit me këtë shumë.

Brenda tremujorit të parë 2015

12. DSHTD ka shpenzuar për gjoba e penalitete si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të stafit përgjegjës të strukturave drejtuese të ngarkuar në bazë të kuadrit rregullator, duke shkaktuar efekte financiare negative në shpenzime për vlerën 39,669,813 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë

Këshilli Drejtues, të analizojnë shpenzimet për gjoba dhe penalitete dhe të nxjerrin përgjegjësitë ndaj punonjësve për veprimet dhe mosveprimet, në zbatim të kuadrit rregullator, pasi për vitin 2013, enti është ndëshkuar me dëmshpërblime nga gjykata me vlerën 39,669,813 lekë.

Brenda muajit janar 2015

13. Drejtori i DSHTD-së ka miratuar praktika për shërbime të kryera në Godinën e Misionit të Përhershëm pranë OKB-së, në cilësinë e pjesëtarit të grupit të punës, në kundërshtim me legjislacionin përkatës, pasi asnjë nga anëtarët e grupit të punës nuk është specialist të fushës.

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtori i DSHTD-së, në formimin e grupeve të punës për evidentimin e nevojave të përfaqësive diplomatike të përcaktojë specialistë të fuqishave përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor, si dhe për një programim të saktë të nevojave të përfaqësive tona diplomatike.

Vazhdimisht

14. Drejtori i DSHTD -së, ka ngritur grupin e punës dhe të vlerësimit të ofertave në kushte të emergjencës dhe të nevojës ekstreme për shërbim interneti, prokurim i cili nuk është kryer nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, sipas legjislacionit të prokurimit publik. Gjithashtu është tejkaluar limiti i prokurimit me vlera të vogla prej 400,000 lekë, pasi kontrata e nënshkruar është me vlerë 937,200 lekë; është kryer likuidimi i situacionit të punimeve pjesore për remont ashensorësh me vlerë 2,016,600 lekë nga kontraktori “**■**” SHPK, pa dokumentacion të plotë justifikues.

Për sa më sipër rekomandojmë

DSHTD, të parashikojë dhe të realizojë procedurat e prokurimit në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Vazhdimisht

15. Nga DSHTD është bërë pagesa e dietave të punonjësve që kryejnë shërbime jashtë vendit, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që trajtohen me shërbime jashtë shtetit”, pa respektuar kriteret e vendosura, për çdo funksion (drejtor apo specialist) për kategoritë e hoteleve sipas yjeve.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga DSHTD, të merren masa që përllogaritja e dietave për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë vendit, të bëhen në përputhje me VKM nr. 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që trajtohen me shërbime jashtë shtetit”, të bëhet diferenca e flete hoteleve sipas VKM në fuqi si dhe të zhduken pranë arkës së institucionit.

Deri më 20.01.2014

16. Punonjësit që janë dërguar me shërbim jashtë shtetit, në kuadër të grupeve të punës për përcaktimin e nevojave nuk kanë qenë specialistë të fushës, si dhe për studimin e tregut dhe për marrjen e ofertave nuk kanë angazhuar punonjës të përfaqësive tona diplomatike, duke reflektuar në programim pasaktësi të shpenzimeve.

Për sa më sipër rekomandojmë

DSHTD, të marrë masa që në grupet e punës të jenë punonjës të fushës, si dhe për studimin e tregut dhe marrjen e ofertave të angazhohen punonjës të përfaqësive diplomatike.

Vazhdimisht

17. Nga DSHTD, janë pranuar dokumente justifikues të fotokopjuar për shërbime (fjetje dhe pagesa tjera), në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe vërtetuese për kryerjen e shërbimit; nuk janë të bashkëlidhura biletat origjinale dhe faturat e hotelit të panëshkruara nga shitësi dhe pa kuponin e kasës fiskale.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga DSHTD të merren masa që të mos pranohen dokumente fotokopje, dokumentacioni të jetë i plotë dhe i shoqëruar me dokumente vërtetuese, të cilat vërtetojnë kryerjen e shërbimit. Fletët e hotelit të jenë të nënshkruara nga shitësi dhe të kenë bashkëlidhur kuponin e kasës fiskale, si dhe biletat origjinale.

Vazhdimisht

18. Në DSHTD, është bërë copëzim i fondeve për investime dhe mirëmbajtje në objekte të veçanta, si: lysterje e objektit, riparime elektrike, riparime hidraulike, riparime kaldaje etj., për rrjedhojë nuk është arritur eficienca dhe efektiviteti i fondeve, pasi çdo vit parashikohen fonde për të njëjtat objekte.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga ana e DSHTD-së të merren masa që në të ardhmen të bëhet planifikimi i saktë për mirëmbajtjen e godinave që janë në pronësi të Shtetit Shqiptar, duke shmangur copëzimin e fondeve dhe përsëritjen e tyre në periudha kohore vjetore.

Vazhdimisht

19. DSHTD, në disa raste ka bërë copëzim të fondeve për prokurime, në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar, për mallra të ndryshme si vegla pune, pajisje kaldajash, hidrosanitare, mirëmbajtje, materiale ndërtimi etj., për të cilat ekzistonte mundësinë e grupimit të mallrave dhe të kryhej procedura përkatëse e prokurimit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga ana e DSHTD-së, në të ardhmen të bëhen analiza dhe vlerësime të hollësishme tekniko-ekonomiko-financiare në mënyrë që treguesit e programit të zhvillimit të jenë reale, dhe për realizimin e tyre të parashikohen dhe zbatohen procedurat përkatëse ligjore të prokurimit.

Vazhdimisht

20. Nga ana e DSHTD-së, nuk është bërë e saktë llogaritja dhe argumentim i fondit limit, situacionet nuk janë hartuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e punimeve”, si dhe VKM nr. 1027, datë 15.12.2010 “Për miratimin manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizën teknike të tyre”, nuk janë përcaktuar qartë specifikimet teknike në rastet e prokurimit të materialeve të ndërtimit etj.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga ana e DSHTD, të merren masat që të bëhen specifikimet teknike sipas kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 2 datë 08.05.2003, Për klasifikimin dhe strukturën e punimeve si dhe VKM nr. 1027 datë 15.12.2010 “Për miratimin manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizën teknike të tyre duhej bërë më e plotë në rastet e punimeve, si dhe me specifikime më të qarta në rastet e prokurimit të mallrave, siç janë materialet e ndërtimit etj.

Vazhdimisht

21. Në hartimin e preventivit paraprak për punime investim- mirëmbajtjes në ambasadat e RSH, nuk janë zbatuar kërkesat e pikës 1, të VKM nr. 30, datë 20.1.2010, VKM 1027 datë 15.12.2010, VKM nr. 708, datë 12.10.2011, VKM Nr. 407, datë 27.6.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre” dhe pikës B/II “Struktura e koston së punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”, pasi mungojnë analizat teknike e strukturës së koston së punimeve të ndërtimit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga ana e DSHTD, të merren masa që në të ardhmen të bëhet hartimi i preventivave sipas ligjeve dhe VKM në fuqi, konkretisht e pikës 1, të VKM nr. 30, datë 20.1.2010, VKM 1027 datë 15.12.2010, VKM nr. 708, datë 12.10.2011, VKM Nr. 407, datë 27.6.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre” dhe pikës B/II “Struktura e koston së punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”.

Vazhdimisht

22. Nga ana e DSHTD, nuk ka të mbajtur procesverbale për kryerjet e punimeve, nuk ka një dosje teknike, nuk ka situacion pjesorë, nuk ka certifikatë të cilësisë së materialeve dhe librezë të masave etj., sipas përcaktimeve të VKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga ana e DSHTD-së, të merren masa që në të ardhmen për çdo shërbim të kryer, në lidhje me punimet lysterje, betonime apo të tjera të kësaj natyre, të mbahen procesverbale ose akte kolaudimi nga një grup pune, të cilët të vërtetojnë kryerjen e këtij shërbimi.

Vazhdimisht

23. Në DSHTD, janë kryer veprime nga arka në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në njësitë e sektorit publik”, pika 64, në të cilën përcaktohet se veprimet nga arka nuk duhet të kalojnë limitin e arkës të përcaktuar në këtë udhëzim.

Për sa më sipër rekomandojmë

Në DSHTD, të merren masa që të zbatohet udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011. “Për menaxhimin e Aseteve në Njësitë e Sektorit Publik” për veprimet që kryhen nga arka.

Vazhdimisht

24. Në DSHTD nuk ka dosje teknike të investimit për çdo objekt në Ambasadat e RSH-së si Athinë, Stokholm, Bruksel, Suedi dhe Rome, pasi investimet në këtë objekte nuk kanë një projekt zbatimi skica për shërbimet teknike. Dosja teknike duhet të jetë e plotë dhe të ketë librezat e masave për çdo investim të kryer brenda dhe jashtë vendit sipas formularëve tip të përcaktuar në aktet ligjore.

Për sa më sipër rekomandojmë

Në DSHTD të merren masat që dosjet teknike të jenë të plota dhe të kenë librezat e masave për çdo investim të kryer brenda dhe jashtë vendit, sipas formularëve tip të përcaktuar në aktet ligjore.

Vazhdimisht

25. DSHTD është e mbingarkuar me staf, sidomos administrativ dhe nuk rezultojnë përpjekje të mjaftueshme për reduktimin e personelit, pasi shpenzimet e pagave zënë 35 % e të ardhurave nga dhënia me qira e objekteve, kryesisht në sektorin juridik dhe prokurimeve, këshilltarja ligjore dhe specialisti i arkivës.

Për sa më sipër rekomandojmë

- Këshilli Drejtues i DSHTD të marrë masa për shkurtimin e stafit dhe sidomos atij administrativ, me qëllim uljen e shpenzimeve për pagat dhe rritjen e performancës së burimeve njerëzore, kryesisht për shkurtimin e stafit në sektorin juridik dhe prokurimeve, pozicionet e punës këshilltare ligjore dhe specialistë i arkivës.

Brenda tremujorit të parë 2015

26. Nivelet e pagave janë miratuar nga organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore, brenda kufirit minimal e maksimal të pagës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare të DSHTD, por nuk janë miratuar nga ministri përkatës, në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011”Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (a).

Për sa më sipër rekomandojmë

- Këshilli Drejtues të marrë masa për miratimin e nivelit të pagave nga ministri përkatës, sipas parashikimit të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011”Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (a).

Brenda muajit janar 2015

27. Sipas Programit ekonomik për vitin 2013 numri mesatar i punonjësve ka qenë 104 dhe paga mesatare lekë 51,890 lekë në muaj, ndërsa sipas evidencave rezulton se numri mesatar ka qenë 109 ose 5 punonjës më shumë, si dhe paga mesatare 49,990 lekë, në tërësi fondi i pagave është realizuar 65,388,223 lekë duke e tejkaluar vlerën e parashikuar me 630,223 lekë.

Sipas Programit ekonomik për vitin 2014 (6 muaji i I) numri mesatar i punonjësve ka qenë 90 punonjës dhe paga mesatare 54,963 lekë në muaj, ndërsa sipas evidencave rezulton se numri mesatar i punonjësve ka qenë 98 ose 8 punonjës më shumë dhe paga mesatare është realizuar 54,697 lekë në muaj dhe në tërësi fondi i pagave është realizuar 32,161,924 lekë me një tejkalim prej 2,481,924 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë

- Strukturat Drejtuese të DSHTD-së të marrin masa që të mos tejkalojnë numrin mesatar të punonjësve si dhe fondin e pagave të parashikuara në programin ekonomik, pasi tejkalimi i fondit të pagave nga programi i tyre ka sjell një efekt negativ mbi rezultatin ekonomik të DSHTD, duke rritur shpenzimet në një kohë kur enti ka pasur penalizim në vlera të konsiderueshme, për pasojë rezultati financiar është negativ.

Vazhdimisht

28. Nga auditimi i procedurave të marrjes në punë të punonjësve konstatohet se nuk janë zbatuar procedurat e parashikuara në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe nuk kanë qenë transparente mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në kundërshtim me Nenin 11, pika 3 e Kontratës Kolektive të Punës nr. 2468 datë 30.12.2011 si dhe me nenin 43, pika 3 të rregullores së brendshme të vitit 2014 dhe vitit 2013.

Për sa më sipër rekomandojmë

Drejtori i DSHTD-së dhe sektori i administratës të zbatojnë procedurat për marrjen në punë të punonjësve sipas Kontratës Kolektive të Punës nr. 2468, datë 30.12.2011 si dhe nenit 43, pika 3 të Rregullores së brendshme.

Vazhdimisht

29. Si rezultat i largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme, DSHTD është penalizuar në vitin 2013 deri në 30.06.2014 nga vendimet e gjykatave në 4 raste në shumën 2,389,265 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. DSHTD si rezultat i penalizimit është rënduar akoma më shumë si rezultat i mungesës së ekzekutimit vullnetar të këtyre vendimeve, por nëpërmjet zyrave të përmbartimit privat, duke ngarkuar me përgjegjësi Drejtorët e DSHTD-së.

Për sa më sipër rekomandojmë

DSHTD të marrë masa në të ardhmen për të zbatuar procedurat ligjore të largimit nga puna të punonjësve, në zbatim të Kodit të Punës dhe Kontratës kolektive, si dhe duke ndjekur me përgjegjësi afatet të përcaktuara sipas shkallëve të gjyqësorit, në mbrojtje të interesave të entit.

Menjëherë

30. Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se, për periudhën e auditimit për vitin 2013 për tenderat e audituar, Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka dërguar një kopje të regjistrit të parashikimeve të prokurimit, si dhe regjistrin e realizimit të prokurimeve në Agjencinë e Prokurimeve Publike, për prokurimet, veprim në kundërshtim me pikën “b” dhe “d” të nenit 3 të VKM-së nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, me ndryshimet.

Për sa më sipër rekomandojmë

DSHTD, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të dërgojë një kopje të Regjistrit të parashikimeve të prokurimit, si dhe Regjistrin e realizimit të prokurimeve në APP, bazuar në pikën “b” dhe “d” të nenit 3 të VKM-së nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, me ndryshimet.

Vazhdimisht

31. Njësia e Prokurimit në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje nuk ka kryer inventarizimin e brendshëm të saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Për sa më sipër rekomandojmë

Njësia e Prokurimit në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje duhet të kryej inventarizimin e brendshëm të saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar

nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Vazhdimisht

32. Titullari i Autoriteti Kontraktor, nuk ka siguruar një ndarje të qartë të detyrave ndërmjet zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 1, germa “a”. Ku thuhet se, “Titullari i Autoritetit Kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së prokurimit. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për zyrtarin e autorizuar prej titullarit të autoritetit kontraktor kryhen në respektim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Për sa më sipër rekomandojmë

Titullari i Autoriteti Kontraktor, të siguroj një ndarje të qartë të detyrave ndërmjet zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 1, germa “a”. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për zyrtarin e autorizuar prej titullarit të autoritetit kontraktor të kryhen në respektim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Vazhdimisht

33. Nga auditimi i procedurave të tenderave gjatë vitit 2013 dhe 6 mujorit të I të vitit 2014 u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

- Në fillim të vitit nuk është ngritur Njësia Prokurimit sipas dispozitave ligjore në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Nuk është bërë një rakordim me magazinën për gjendjen aktuale të mallrave në mënyrë që të studiohej nevoja për çdo mall për vitin në vazhdim.
- Titullari i Autoritetit kontraktor ka bërë shtesa kontrate të paargumentuara dhe të pabazuara në dispozita ligjore, për disa nga zërat e materialeve që aktualisht kanë qenë gjendje në magazinë.
- Preventivi nuk është hartuar nga personat me kualifikimin e duhur për procedurën “Remont kapital ashensorësh”.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga DSHTD të merren masa që në të ardhmen në fillim të çdo vitit kalendarik dhe gjatë veprimtarisë të saj:

- *Të ngrihet Njësia e Prokurimit sipas dispozitave ligjore, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.*
- *Të bëhet një rakordim me magazinën për gjendjen aktuale të mallrave në mënyrë që të studiohet nevoja për çdo mall për vitin në vazhdim dhe të mos krijohen mallra stok.*
- *Titullari i Autoritetit kontraktor nuk duhet të bëjë shtesa kontrate të paargumentuara dhe të pabazuara në dispozita ligjore.*

- Autoriteti Kontraktor, në çdo rast preventivat, të bëhen nga inxhinier të fushës të cilët disponojnë licencat përkatëse.

Vazhdimisht

34. Në DSHTD nuk është implementuar Ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, mënyrën e analizës së menaxhimit të riskut, për t’u njohur më mirë me konceptet e ligjit, si dhe komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga Drejtori i DSHTD-së, të merren masa, për të bërë kualifikime e seminare për njohjen me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, mënyrën e analizës së menaxhimit të riskut, për t’u njohur më mirë me konceptet e ligjit, si dhe komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të gjithë menaxherët e shoqërisë, me qëllim implementimin dhe zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim evidentimin dhe njohjen e shpërbllim dëmit në vlerën 2,862,440 lekë.

1. Konstatohet se është paguar vlera e kontratës e lidhur me ekspertin kontabël, vlera e kontratës është më e lartë nga vlera e programuar dhe nga vlera me të cilën është ofruar i njëjti shërbim dhe nga i njëjti subjekt vitet e shkuara. Vlera e kontratës së lidhur me ekspertin është 780,000 lekë pa TVSH dhe jo 400,000 lekë pa TVSH sipas vlerës së planifikuar në programin ekonomiko-financiar duke i shkaktuar një dëm ekonomik prej 380.000 lekë (780,000-400,000) DSHTD-së

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 380,000 lekë (pa t.v.sh), duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, për z. [REDAKTUAR] i cili ka firmosur kontratën me vlerë me të madh nga parashikimi.

2. Është kryer pagesa me vlerën 700,000 lekë, me përfitues “[REDAKTUAR]” shpk në zbatim të urdhrit nr. 23 datë 20.03.2013, “Për sponsorizim”, sipas vendimit të këshillit drejtues nr. 2 datë 19.03.2013, është paguar 700 000 lekë, për sponsorizimin e aktivitet sportiv të peshëngritjes në kuadrin e kampionatit Evropian. Bashkëlidhur praktikës është fatura tatimore datë 26.03.2012, në emër të subjektit “[REDAKTUAR] shpk, ku janë likuiduar disa vegla. Gjithashtu pagesa është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” neni 4, pikën 26,

përkufizimet thuhet “Dokumenti financiar është çdo informacion origjinal, plotësues si dhe të dhënat kontabile të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara apo të marra nga njësi publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruaj me vërtetësi veprimin ose ngjarjen që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes, objektin treguesit sasi dhe vleror, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprime e tjera të dhëna të nevojshme që i japin një dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”. Fatura e likuiduar nuk është në favor të Federatës Shqiptare të Peshëngritjes, për të cilën Këshilli Drejtues ka marrë vendimin e sponsorizimit dhe urdhrit të Drejtorit nr. 23 datë 20.03.2013, por të subjektit privat “[REDAKTUAR]”. E gjithë vlera e sponsorizimit prej 700,000 lekësh përbën dëm ekonomik.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 700,000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, për z. [REDAKTUAR] i cili ka firmosur likuidimin e faturës ndaj firmës “[REDAKTUAR]”.

3. Nëpërmjet urdhrave nr.36, nr.37, nr.38 dhe nr.39 të datës 02.04.2013 për ngritjen e grupeve të punës me qëllim “Kontrollin në vend të nevojave për sigurimin e kushteve optimale për diplomatët e përfaqësive tona etj...” në shtetet Belgjikë, Itali, Suedi dhe Greqi. Në zbatim të këtyre urdhrave pa ndonjë procedurë ligjore është kontaktuar menjëherë agjencia e udhëtimit “[REDAKTUAR]”, në kundërshtim me Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM Nr.1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, e cila ka bërë blerjen e biletave dhe hotelin për secilin punonjës. Vëmë në dukje se pagesa është bërë më datë 04.04.2013, pra likuidimi është bërë fiktiv dhe është bërë një muaj para se grupet e punës do të niseshin me shërbim, në praktikën bashkëlidhur janë biletat e udhëtimit si dhe akomodimi në hotel i punonjësve. Të gjitha shpenzimet për këto shërbime të pa kryera përbëjnë dëm ekonomik në vlerën $10938 \text{ euro} \times 140 = 1,531,320 \text{ lekë}$.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 1,531,320 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, për z. [REDAKTUAR] i cili ka nxjerr urdhrat dhe ka firmosur pagesën ndaj agjencia e udhëtimit “[REDAKTUAR]”.

4. Është paguar nga arka me vlerë 110,000 lekë, matësi elektrik praktika nuk ka dokumentet justifikues, kjo praktikë është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kjo praktikë përbën dëm ekonomik në vlerën 110,000 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të nxirret përgjegjësia dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 110,000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative.

5. Nga ana e DSHTD-së janë kryer punime në Ambasadën Rome/Itali. Ku rezulton se në situacion kanë vendosur vlerën prej 1008 euro (141,120 lekë), bileta taksi pa destinacion dhe pa pasur një shpjegim për to nëse janë përfshirë në situacionin e punimeve.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 141,120 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, për grupin e punës që ka shkuar në Ambasadën tonë në Romë, pasi biletat e taksisë janë pa destinacion.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, me ndryshimet e mëvonshme, si dhe Kontratën kolektive, neni 18, kërkojmë nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. “Vërejtje me shkrim”, për:

1. zj. ■■■■ në cilësinë e anëtares së Këshillit Drejtues, për arsye se:

- ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 244 datë 27.05.1993, “Për sponsorizimet nga ndërmarrjet shtetërore të subjekteve të ndryshme” duke vendosur për sponsorizimin në vlerën 700,000 lekë.
- si pjesë e vendimmarrjes, ka vendosur që tarifat e qirasë për sipërfaqen e objektit 259 m², të jetë 400 lekë m² (katërqind leke m²) dhe për sipërfaqen 254.5 m²truell i lirë funksional tarifa të jetë 200 lekë m² (dyqind lekë m²), me afat të dhënies me qira për 20 vjet pa marrë parasysh indeksimin e çmimeve për periudhën afatgjatë.
- si pjesë e vendimmarrjes, ka miratuar kriteret e marrjes në punë sipas pozicionit të punës, ku konstatohet se kriteret e vendosura janë të përgjithshme, pa u specifikuar saktë, pa ndarje të specialistëve në kategori dhe në disa raste pa u përcaktuar dhe lloji i arsimit dhe niveli arsimor.
- si pjesë e vendimmarrjes ka miratuar propozimin e Komisionit Teknik të Vlerësimit dhe ka vendosur nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të DSHTD-së për vitin 2012, në vlerën totale 1.739.850 lekë, pa bërë analizën një për një të mallrave që janë nxjerrë jashtë përdorimit së bashku me dokumentacionin përkatës për çdo artikull që nuk ka plotësuar normën e amortizimit.

2. ■■■■ me detyrë specialist preventivues në Sektorin e Planifikimit, për arsye se:

- ka hartuar preventivin për “Remont kapital ashensorësh” pa pasur kualifikimin e nevojshëm të inxhinierit mekanik dhe duhej të dispononte licencë NS-3, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit.
- ka hartuar materiale jo të plota të cilat i janë paraqitur Këshilli Drejtues ka miratuar propozimin e Komisionit Teknik të Vlerësimit dhe ka vendosur nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të DSHTD-së për vitin 2012, në vlerën totale 1.739.850 lekë, pa bërë analizën një për një të mallrave që janë nxjerrë jashtë përdorimit së bashku me dokumentacionin përkatës për çdo artikull që nuk ka plotësuar normën e amortizimit.
- ka qenë pjesë e vendimmarrjes së lidhjes së kontratës së qirasë me Fondin “Besa” në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” si dhe Udhëzimit nr. 906, datë 21.11.2001 “Për zbatimin e VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” për sa i përket afatit të kontratës së kryer pa miratimin të MPJ- së me një tarifë minimal për një subjekt të tillë financiar.

- nuk ka mbajtur procesverbale për kryerjet e punimeve, nuk ka një dosje teknike, nuk ka situacion pjesorë nuk ka certifikatë të cilësisë së materialeve,librezë të masave etj.

3. z. ■■■ me detyrë Shefit të Sektorit të Planifikimit, për arsye se:

- nuk kanë hartuar një udhëzim për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programeve ekonomike financiare ku të përcaktohen: proceset e hartimit të programit të zhvillimit, procedurat e miratimit dhe afatet e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programit të zhvillimit.
- planifikime jo të sakta pasi shihen bërë tejkallim planit dhe shpenzimet janë realizuar 130% ose 30% më shumë se plani. Në zërin e pagave dhe të shërbimeve të ndryshme e sidomos në shërbime e dieta. Mos parashikimi i saktë ka sjell situatë financiare të pa qartë për ndërmarrjen

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, i sugjerojmë trajtimin e detajuar juridik nga ana e Drejtorisë Juridike, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, është kallëzuar penalisht njw person

1

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Ina Sokoli, Valdete Berisha, Pranvera Doçi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Sekretariri i Përgjithshëm Luljeta Nano.

KONTROLI I LARTË ISHTETIT